

Shërbimi i urgjencave

Traumë në kokë te të rriturit

Këshilla për kthimin tuaj në shtëpi



Ju keni pësuar një goditje në kokë. Ky dokument ju jep informacione mbi masat që duhen marrë dhe mbikëqyrjen tuaj të vazhdueshme, pas daljes nga spitali.

Çfarë ka ndodhur?

Ju keni pësuar një traumë në kokë ose një tronditje në tru. Rezultatet e kontrollit tuaj nuk janë shqetësuese dhe nuk ka asnjë shenjë që gjendja juaj të jetë e rëndë.

- ☐ Bërja e një skaneri të trurit nuk gjykohet e nevojshme, në dritën e aksidentit dhe ekzaminimit tuaj klinik.
- ☐ Një skaner i trurit është kryer; ai nuk ka treguar asnjë lëndim të ndodhur si pasojë e traumës suaj.

Kthimi juaj në shtëpi është i mundur, por duhet të merren disa masa paraprake.

Porosi që duhen ndjekur

Paraprakisht, duhet të merren masat e mëposhtme për shmangien e ndërlikimeve të mundshme:

- ▲ Pushoni.
- ▲ Pini ujë dhe hani në mënyrë normale.
- ▲ Mos merrni hape gjumi apo ilaçe kundër dhembjes përveç paracetamolit, veç nëse mjeku ka mendim të kundërt.
- ▲ Shmangni pirjen e alkoolit e të drogën gjatë të paktën 3 ditëve.
- ▲ Rifilloni gradualisht veprimtaritë tuaja të zakonshme në ditët në vijim.
- ▲ Pakësoni përdorimin e ekraneve sa më shumë që të jetë e mundur.
- ▲ Mos bëni veprimtari sportive, sa kohë që paraqitni ende shenja.
- ▲ Mos bëni veprimtari që shoqërohen me një rrezik të lartë për të lënduar kafkën e kokës.

Cilat janë shenjat paralajmëruese?

Ndërlikimet e traumës në kokë janë të rralla, por duhet të identifikohen me kohë, atëherë kur ato ndodhin. Ndër to, edhe pse shumë e rrallë, gjakrrjedhja brenda kafkës paraqet një rrezik shumë serioz. Ajo ndodh më shpesh brenda një periudhe prej 24 orësh pas aksidentit.

Shenjat paralajmëruese

Thërrisni menjëherë nr. tel. 144, nëse vëreni ndonjë nga shenjat e mëposhtme:

- ▲ Përgjumje e madhe
- ▲ Dhembje koke që rëndohet me shpejtësi
- ▲ Përzierje dhe të vjella të përsëritura
- ▲ Spazma
- ▲ Mpirje ose rënie e forcës apo ndjeshmërisë së një gjymtyre.
- ▲ Vështirësi në të folur, pështjellim ose sjellje anormale
- ▲ Turbullim i shikimit ose i dëgjimit
- ▲ Çrregullime të ekuilibrit

Shenjat e shpeshta dhe normale

Shenjat e mëposhtme zakonisht zhduken pas disa ditësh, madje disa javësh.

- ▲ Lodhje
- ▲ Dhembje koke e lehtë
- ▲ Marrje mendsh
- ▲ Çrregullime të kujtesës
- ▲ Dëshirë për të fjetur
- ▲ Acarueshmëri
- ▲ Nervozizëm
- ▲ Ndjeshmëri ndaj zhurmës dhe dritës



Skanoni për gjuhët e tjera
Scan for other languages